

KUJDES! MOS DËMTO BARKODIN

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2009

LËNDA: GJEOGRAFI

VARIANTI B

E premte, 10 korrik 2009

Ora 10.00

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **20 pyetje**.

Në test ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**.

*Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.*

Koha për zhvillimin e kërkesave të testit është **2 orë**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Pikët										
Kërkesa	11	12	13a	13b	14	15a	15b	15c	16	17
Pikët										
Kërkesa	18	19	20a	20b						
Pikët										

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.Anëtar

2.Anëtar

1. Lumi më i gjatë në Rusinë evropiane është: **1 pikë**
- A) Danubi
B) Dniepri
C) Vollga
D) Doni
2. Ndodhen paralel me vijën bregdetare të Paqësorit në Amerikën e Veriut malet: **1 pikë**
- A) Sierra Madre Lindore
B) Shkëmbore
C) Apalashë
D) Kordiliere
3. Gadishulli, i cili laget nga ujërat e Detit të Kuq, Detit Arabik dhe Gjirit Persik është ai i: **1 pikë**
- A) Indokinës
B) Arabik
C) Industanit
D) Sinaït
4. Cila nga alternativat e mëposhtme është veçori e bregdetit të detit Jon? **1 pikë**
- A) është bregdet i tipit të ulët
B) mbizotëron procesi i grumbullimit
C) mbizotërojnë plazhet ranorë
D) mbizotërojnë brigjet e thepisura.
5. Një nga pasojat gjeografike të rrotullimit të Tokës rreth Diellit është: **1 pikë**
- A) llogaritja e kohës lokale
B) formimi i ditës dhe natës
C) ndryshimi i vendit të lindjes dhe perëndimit të Diellit
D) zhvendosja e trupave që lëvizin horizontalisht.
6. Shteti i cili dallohet për pasuri të diamantit në kontinentin e Afrikës është: **1 pikë**
- A) Afrika e Jugut
B) Kameruni
C) Algjeria
D) Uganda
7. Mbart vlera materiale dhe jo materiale (kulturore dhe shpirtërore) për kombin: **1 pikë**
- A) trashëgimia natyrore
B) trashëgimia botërore
C) trashëgimia kulturore
D) trashëgimia kombëtare

8. Sthrihet në lindje të luginës së Drinit të Zi e të Bardhë, në kufi me Kosovën dhe ish RJ të Maqedonisë. Bëhet fjalë për:

1 pikë

- A) Vargjet e Lurës
- B) Vargun e Korabit
- C) Vargjet e Skënderbeut
- D) Malësinë e Martaneshit

9. Bota shtazore e Australisë ka disa veçori origjinale ndryshe nga kontinentet e tjerë për shkak të:

1 pikë

- A) shkëputjes shumë herët të këtij kontinenti nga kontinentet e tjerë
- B) kushteve të njëjta natyrore
- C) veçorive të përbashkëta klimatike
- D) shkëputjes shumë vonë të këtij kontinenti nga kontinentet e tjerë.

10. Si rrjedhojë e veprimtarisë gërryese të deteve format e relievit që krijohen janë:

1 pikë

- A) kordonët litoralë
- B) falezat
- C) shigjetat litorale
- D) plazhet.

11. Përcaktoni dy sistemet kryesore kodrinore të Shqipërisë.

2 pikë

- a) _____
- b) _____

12. Klasifikoni qytetet e trevave shqiptare sipas kohës së ndërtimit.

4 pikë

- a) _____
- b) _____
- c) _____
- d) _____

13. Gjeni dhe analizoni dy faktorët kryesorë që përcaktojnë qarkullimin e përgjithshëm të atmosferës.

a) faktori I: _____ 2 pikë

faktori II: _____

b) analiza: _____ 2 pikë

14. Përcaktoni tre nga periudhat e emigrimit masiv të popullsisë shqiptare. **3 pikë**

- a) _____
- b) _____
- c) _____

15. Përkufizoni konceptet:

a) Atmosferë _____ **1 pikë**

b) Hidrosferë _____ **1 pikë**

c) Biosferë _____ **1 pikë**

16. Relievi i Rajonit Juglindor është tepër i larmishëm, i çrregullt, shumë i copëtuar dhe me kontraste të mëdha. Renditni tre nga faktorët që kanë kushtëzuar këtë reliev. **3 pikë**

- a) _____
- b) _____
- c) _____

17. Renditni të paktën dy nga ngjarjet kryesore që kanë ndodhur gjatë periudhës së katërsorit në trevat shqiptare. **2 pikë**

- a) _____
- b) _____

18. Listoni dy arsye pse SHBA dhe BS konkurronin për ndikim dhe aleatë në vendet e Lindjes së Mesme. **2 pikë**

- a) _____
- b) _____

19. Evidentoni tre nga faktorët natyrorë që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të trevave shqiptare. **3 pikë**

- a) _____
- b) _____
- c) _____

20. Tregoni se në cilën njësi fiziko – gjeografike është përqëndruar pjesa më e madhe e popullsisë në Alpet Shqiptare dhe renditni tre nga arsyet e vendosjes.

a) njësia fiziko – gjeografike: _____ **1 pikë**

b) arsyet: **3 pikë**

I: _____

II: _____

III: _____